



# Qeverisja e Mirë – Punët e Brendshme dhe të Drejtësisë Projekti “Përkrahje për Policinë”

[kliko këtu për qasje](#)

Projekt i financuar nga BE menaxhuar nga Agjencioni Evropian për Rindërtim

Realizuar nga ICON-INSTITUT Public Sector GmbH drejtues i konzorciumit



## Prapavija

Një konzorcium i udhëhequr nga ICON-INSTITUT Public Sector GmbH (ICON) është kontraktuar nga AER-i në Kosovë për implementimin e Projektit CARDS “Përkrahje për Policinë”.

## OBJEKTIVAT DHE REZULTATET E PRITURA

### Synimet e përgjithshme

Synimet e përgjithshme të projektit janë si vijon:

- Përkrah transferimin e përgjegjësiave të çështjeve të Brendshme dhe Policisë nga UNMIK-u tek autoritetet publike pasuese dhe asistojë në krijimin e një Ministrie të Punëve të Brendshme të qëndrueshme dhe të zbatueshme përmes një sfoere të masave për ndërtim të kapaciteteve
- Asistojë zhvillimin dhe përforcimin e strukturave efektive të drejtësisë dhe politikave në Kosovë, të cilat garantojnë një hapësirë lirie, sigurie dhe drejtësie për të gjithë qytetarët e Kosovës, në pajtueshmëri me standardet dhe praktikatat më të mira të BE-së



### Synimet specifike

Synimet specifike të Ekipit të Projektit janë për të mbështetur Ministrinë e Punëve të Brendshme në katër faza të lidhura ngushtë: domethënë, ndërtimi i institucioneve, ngritja e kapaciteteve, përkrahje Shtyllës së Krimin brenda Shërbimit Policor të Kosovës dhe monitorim dhe vlerësim pasues.

***Faqja e ardhshme***



# Synimet specifike

Qeverisja e Mirë –  
Punët e Brendshme dhe të Drejtësisë  
Projekti “Përkrahje për Policinë”

Për më shume detaje kliko mbi tabelë

## Komponenta 1: Ndërtimi i Institucioneve

- 1.1 Shqyrtimi i legjislativit
- 1.2 Zhvillimi i një Deklarate të Misionit
- 1.3 Zhvillimi i një Strukture për MPB-në
- 1.4 Përkrahje në procesin e rekrutimit dhe selektimit
- 1.5 Zhvillimi i përshkrimeve të detyrave dhe vendeve të punës/profilit e punës
- 1.6 Zhvillimi i Procedurave Standarde Operative
- 1.7 Përkrahje sektorit për Media dhe MP të MPB-së
- 1.8 Zhvillim i metarialeve të informatave publike
- 1.9 Zhvillimi / zbatimi i strategjisë së gjetjes së fondeve dhe buxhetit
- 1.10 Vlerësimi i kërkesave të pajisjeve të TI & Komunikimit
- 1.11 Zhvillimi i urdheresës së procesimit të të dhënave personale të SHPK-së
- 1.12 Zhvillimi i draft Instrumenteve legjislative

## Komponenta 2: Ndërtimi i Kapaciteteve

- 2.1 Zhvillimi i politikave të BNj dhe strategjisë së punësimit
- 2.2 Vlerësimi i Nevojave të Trajnimit
- 2.3 Zhvillimi i planit/modulave të trajnimeve
- 2.4 Dorëzimi/ofrimi i modulave të trajnimit
- 2.5 Praktikrat në Vendet Antare të BE-së
- 2.6 Përkrahja e harmonizimit të sistemeve të TI-së kufitare/migrimit
- 2.7 Identifikimi i nevojave të pajisjeve
- 2.8 Përkrahja e kornizave ligjore dhe sistemeve për kufij/migrim/azil

## Komponenta 3: Përkrahja e Shtyllës së Krimit të SHPK-së

- 3.1 Vlerësimi i Nevojave të Trajnimit
- 3.2 Zhvillimi i Planit të Trajnimit
- 3.3 Realizimi i trajnimeve
- 3.4 Trajnimi i Trajnerëve
- 3.5 Praktikrat në Vendet Antare të BE-së
- 3.6 Rishqyrtimi i legjislacionit lidhur me KO
- 3.7 Rritja ndër-agjencione e luftës kundër krimit ndër-kufitar dhe KO

## Komponenta 4: Monitorimi / Vlerësimi

- 4.1 Dizajnimi i tabelës/matricës së standardeve /treguesve të performancës
- 4.2 Përgatitje të raporteve mujore
- 4.3 Këshilla/ mbështetje teknike për Ministrin dhe Sekretarin Permanent
- 4.4 Rekomandimet për ndërtim të mëtutjeshëm institucional / kapacitete

**Faqja e ardhshme**



## Komponenta 1: Masat për ndërtimin e - Institucioneve

- **Legjislacioni:** Këshilltari po bën një rishqyrtim të hollësishëm të legjislacionit aktual dhe po i identifikon mangësitë dhe fushat të cilat kërkojnë përforsim, **krijimin dhe draftimin (hartimin) e rregulloreve të nevojshme ligjore** të cilat do të realizohen nga Ministria duke përfshirë edhe krijimin e procedurave të brendshme dhe strategjinë e komunikimit, qarkullimin dhe kompjuterizimin e dokumenteve, duke mbajtur në mend nevojën e harmonizimit me ligjet e BE-së. Këshilltari po e vlerëson ndikimin e këtij rishqyrtimi legjislativ me ligjet mbi krimin e organizuar dhe gjyqësorin që të siguroj bashkëpunim efikas ndër-departamente dhe garantoj të drejtat e komuniteteve pakicë dhe të drejtat e grave.
- **Financat:** Krijimi dhe implementimi i Strategjisë për Menaxhimin e Buxhetit, Strategjisë për Ngritje të fondeve për nevojat e ardhshme të Ministrisë, duke përfshirë planin investues shumëvjeçar.
- **Mediat/Marrëdhëniet Publike:** Këshilltari po e përkrah Ministrinë në sektorin për media/marrëdhënie publike për të trajtuar stafin, për tu ngritur vetëdijen dhe informimin e qytetarëve në kuptimin e synimeve dhe aktiviteteve të Ministrisë duke siguruar që informimin të komunitetet pakicë. Po e përkrah Ministrinë dhe kabinetin dhe përfaqësues të tjerë duke u jap këshilla dhe ndihmë në marrëdhënie me media dhe popullatën. Këshilltari së bashku me përfituesin do të zhvillojnë, drejtojnë dhe mbikëqyrin projektet për informimin e qytetarëve, duke drejtuar punën e një grupi gazetarësh dhe koordiminin e aktiviteteve të Ministrisë për media dhe informimin në periudhën e tranzicionit.
- **Teknologjia Informative:** Këshilltari po bën një vlerësim të teknologjisë informative dhe nevojave për pajisjet e komunikimit brenda Ministrisë së re të Punëve të Brendshme në mënyrë që të krijoj një sistem komunikimi modern dhe të strukturave të saj të përkrahjes së menaxhimit informativ në kuadër të Ministrisë dhe që të siguroj integrimin e saj me sistemet e planifikuara ekzistuese të menaxhuara nga agjencionet tjera dhe në veçanti ato të shoqëruara në luftën kundër krimit të organizuar. Vlerësimi do të përqendrohet vetëm në krijimin e lehtësive teknike për sektorin e TI-së. Këshilltari gjithashtu po e ndihmon Ministrinë në aktivitetet për ngritjen e fondeve.



***Kthehu tek tabelat***

***Faqja e ardhshme***



## Komponenta 2: Masat për ndërtimin e Kapaciteteve

- **Ndërtimi i Kapaciteteve** në kuadër të Ministrisë së ardhshme të Punëve të Brendshme me përqendrim në Kufij/migrim dhe departamentin për dokumentet civile përfshirë edhe procedurat për azil.
- **Burimet (Resurset) Njerëzore:** Krijimi i Rregullores për Burimet Njerëzore dhe strategjisë së punësimit, duke përfshirë edhe ngritjen e fuqisë punëtore dhe implementimin e kësaj strategjie, vendos fillimet e zhvillimit në Drejtorinë e BNj dhe drejtorive tjera, me përqendrim në grupet e caktuara të identifikuara dhe duke siguruar përfshirjen e grupeve të ndjeshme të popullsisë përmes niveleve të shumëllojshme hierarkike.
- **Logjistika:** Këshilltari po punon me përfituesit/partnerët në projekt dhe po elaboron hollësitë e përshtatshme teknike për pajisjet për zyre dhe nevojat e renovimit të objekteve të Ministrisë.
- **Trajnimi:** Analizë e thellë e Nevojave për Trajnim për sektorët e ndryshëm në kuadër të Ministrisë së re duke përfshirë edhe trajnimin e trajnerëve civil profesional të Kosovës për t'i përmbushur standardet e BE-së; përgatitje dhe shpërndarje të moduleve trajnuese në shkallë të vogël, në koordinim me organizuesit aktual të trajnimeve. Këto aktivitete trajnuese janë përfshirëse si për kah gjinia ashtu edhe për pakica.



***Kthehu tek tabelat***

***Faqja e ardhshme***



### Komponenti 3: Përkrahja e Shtyllës për Krime në kuadër të Shërbimit Policor të Kosovës

Niveli aktual i kapacitetit të personelit në kuadër të institucioneve ekzistuese në sistemin e Policisë është gjerësisht i pranuar si modest, duke ndryshuar nga një departament në tjetrin. Zyrtar themelorë shtesë, trajner, ekspertizë e pavarur metodologjike, ndihmë teknike për zhvillimin e aftësive në lidhje me planifikimin/punën strategjike të procedurave, trajnimet jashtë vendit, etj. janë të identifikuar si të nevojshme po thuaj për të gjitha institucionet

Ekipi i Projektit dhe në veçanti Ekspertët e Lartë të Policisë me ndihmën dhe në bashkëpunim me SHSHPK-n po:

- Zhvillojnë dhe realizojnë aktivitete **trajnuese** me përfshirjen dhe kontributin e dhënë nga ekspertët lokal edhe institucionet jashtë vendit në fusha të ndryshme të Shtyllës për Krime duke përfshirë Trajnimin e Trajnerëve. Këshilltari po bën një analizë të thellë për nevojat trajnuese për Drejtoritë në kuadër të Shtyllës për Krime dhe dorëzon raport të qartë për ato nevoja, identifikimin e trajnimit të përshtatshëm, krijimi dhe implementimi i saktë i orarit me plane përkrahëse zhvillimore.
- Po bën rishqyrtimin e legjislacionit lidhur me luftën kundër krimit të organizuar me synim të rekomandimit për harmonizim sa më të madh me legjislacionin e BE-së dhe, duke vepruar kështu, e ngrit bashkëpunimin ndër-departamental në luftën kundër krimit të organizuar dhe luftimin e krimit ndër-kufitar ndërkombëtar.



***Kthehu tek tabelat***

***Faqja e ardhshme***



#### **Komponenti 4: Monitorimi dhe Vlerësimi**

- Këshilla Politike drejtuar Sekretarit të Përhershëm dhe Ministrit gjatë periodës së Projektit, pasi Kabineti i Ministrit të jetë plotësisht operativ përmes trajnimit dhe këshillimit nga të gjithë sektorët e ndryshëm në Ministri.
- Bën monitorimin dhe vlerësimin e stafit të Ministrisë dhe bën raportin duke përfshirë edhe rekomandimet e bëra për përmirësimin e kryerjeve të detyrave
- Siguron ndërtim të mëtutjeshëm të masave për ndërtim të kapaciteteve dhe ndërtim të institucioneve.

***Kthehu tek tabelat***

***Kthehu në faqën kryesore***